



REPUBLIKA E KOSOVES-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO



Pranuar / Dorezuar Primijeno/Prodato Received/Delivery	16	01	3	viti god year
Organ/Njësia Org./Jedinica Org./Unit	SIRMSTEC	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
		352/2023		912



Republika e Kosovës Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.1093/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Jeton Koca-kryetar, Ardita Haxhnikaj-Demi dh Eshref Shabani-anëtarë, me Sabile Avdyli-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, duke vepruar sipas ankesës A.nr.1093/2022 të datës 02.12.2022 të parashtruar nga ankuesi me adresë banimi: Rr "Mbreti Bardhyl" A/89 Mitrovicë, në çështjen juridike "*Shkelje e të drejtës në pagë*", në mbështetje të nenit 6 paragrafi 1 nën paragrafin 1.1, nenit 16 paragrafi 3 dhe nenit 18 paragrafi 1 nën paragrafin 1.5 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, si dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 16.01.2023, mori këtë:

V E N D I M

Përfundon procedimi administrativ i filluar sipas ankesës me numër A.nr.1093/2022 të datës 02.12.2022 të parashtruar nga ankuesi

A r s y e t i m

Ankuesi Zyrtarë i Lartë për Çështje Juridike në Drejtorinë për Planifikim dhe Urbanizëm, në Komunën e Mitrovicës, më datë 02.12.2022 ka parashtruar ankesë me numër të protokollit 7599/2022 të regjistruar nën shenjen A.nr.1039/2022 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, lidhur me harmonizimin e koeficientit të pagës me titullin e pozitës dhe përshkrimin e vendit të punës, nga koeficienti aktual shtatë (7) në koeficientin e pagës tetë (8).

Kolegji i Këshillit duke marr parasysh se pretendimet ankimore të ankuesve kanë për objekt çështjen e harmonizimit të koeficientit të pagës, thekson faktin se Kuvendi i Republikës së Kosovës, me datë 22.12.2022 ka aprovuar Ligjin Nr.08/L-196 për Pagat në Sektorin Publikë, i cili me datë 05.01.2023 është publikuar në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës Nr.1/5 Janar 2023, dhe si rrjedhojë i njëjti hynë në fuqi një (1) muaj pas publikimit në gazetë zyrtare. Me këtë ligj parashihen rregulla dhe kushte tjera për përcaktimin e pagës të të punësuarve në sektorin publikë, duke përfshi edhe koeficientet dhe nivelet e koeficienteve të pagës të cilat ndryshojnë nga rregullat dhe sistemi aktual i pagave.



Për me tepër, me dispozitat kalimtare të këtij ligji shfuqizohet Ligjit Nr.03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civil, ndërsa me nenin 42 paragrafi 1 është përcaktuar se gjatë periudhës tranzitore të kalimit në sistemin e ri të pagave, ndalohej çdo ndryshim në strukturën, komponentët apo nivelet e koeficienteve aktual të pagave.

Andaj, për sa me sipër dhe duke marr parasysh faktin se pas parashtrimit të ankesës nga pala ankuese kanë ndryshuar rrethanat ligjore dhe faktike mbi të cilat janë ngritur pretendimet ankimore, Kolegji i Këshillit konstaton se objekti për të cilën ka filluar procedimi administrativ është bërë i pamundur apo i kotë, ngase edhe nëse do të kishte vendimmarrje pozitive, për shkak të rrethanave të krijuara si pasojë e bazës së re ligjore, koeficienti i ndryshuar i pagës nuk mund të aplikohet në sistemin e ri të pagave.

Kështu që duke u bazuar në dispozitat e Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, përkatësisht nenin 104 ku përcaktohet se: *Procedura administrative gjithashtu përfundon kur organi publik kompetent vlerëson se objekti për të cilin ishte nisur procedura ose qëllimi i saj është bërë i pamundur apo i kotë*, si dhe nenin 6 paragrafi 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafin 1.5 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji i Këshillit vendosi për përfundimin e procedimit administrativ, si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda. A.nr.1093/2022

Sabile Avdyli

Sabile Avdyli
Procesmbajtëse



Vendimi i dorëzohet:

- Ankuesit;
- Kryetarit të Komunës së Mitrovicës;
- Udhëheqësit të Personelit në Komunën e Mitrovicës; dhe
- Arkivit të KPMSHCK- së.

